

Kodi i Etikës i Furnitorëve

Në Fruit of the Loom dhe kompanitë tona partnere ("FOTL"), jemi të përkushtuar që të zhvillojmë biznes në përputhje me standardet më të larta të etikës së biznesit dhe respektit për të drejtat e njeriut dhe mjedisin. Ne kërkojmë të njëjtin angazhim nga të gjitha objektet tona që furnizojnë produktet tona, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, kontraktorët, të licencuarit dhe partnerët e tjerë të përcaktuar të biznesit (kolektivisht të referuar si "Furnitorët"). Kodi i Etikës së Furnitorëve reflekton standardet sipas të cilave ne sigurojmë që angazhimi të përmbushet nga Furnitorët tanë dhe drejtohet nga parimet nga Konventat Themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe Kodi i Etikës në Vendin e Punës të Shoqatës për Punë të Drejtë.

ME FOKUS TE NJERËZIT

Marrëdhëniet e punës: Furnitorët do të pranojnë dhe do t'u përmbahen rregullave dhe kushteve të punësimit që respektojnë punonjësit dhe minimalisht do të mbrojnë të drejtat e tyre sipas ligjeve dhe rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare të punës dhe sigurisë sociale.

Shëndeti dhe siguria: Furnitorët do të ofrojnë një ambient pune të sigurt dhe të shëndetshëm për të parandaluar aksidentet dhe lëndimet ndaj shëndetit për shkak të operacioneve të Furnitorit. Kushtet nëpër ambientet e Furnitorit, duke përfshirë fjetoret që zotërohen ose operohen nga Furnitori, duhet të jenë të sigurt, të pastra dhe duhet të plotësojnë ose tejkalojnë kërkesat e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në lidhje me sigurinë dhe shëndetin. Punëtorët duhet të jenë të trajnuar dhe të pajisur për të kryer punën e tyre në mënyrë të sigurt.

Puna e fëmijëve: Furnitorët nuk do të punësojnë individë duke shkelur moshën lokale të arsimit të detyruar ose që janë nën moshën ligjore në fuqi për punësimin. Në asnjë rast Furnitorët nuk do të punësojnë punonjës nën moshën 15 vjeç, përveç aktorëve ose modeleve fëmijë që përdoren në reklama ose në media, dhe atëherë vetëm në përputhje me rregulloret në fuqi për punën e fëmijëve.

Puna e detyruar: Furnitorët nuk do të përdorin punën e detyruar, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, punën e të burgosurve, punën me kontratë të detyruar ose punën e skllevërve apo punën me robërim për shkak të borxhit. Furnitorët do të miratojnë masa për t'u siguruar që ambientet të mos përdoren në trafikimin e qenieve njerëzore dhe do të monitorojnë zinxhirin e tyre të furnizimit për praktika të tilla.

Ngacmimi ose abuzimi: Furnitorët duhet t'i trajtojnë të gjithë punonjësit me respekt dhe dinjitet. Furnitorët do të aplikojnë procedura për t'u siguruar që asnjë punonjës të mos pësojë ngacmim ose abuzim fizik, seksual, psikologjik ose verbal.

Mosdiskriminimi: Furnitorët nuk do të diskriminojnë në punësim duke përfshirë marrjen në punë, kompensimin, përparimin në karrierë, disiplinën, përfundimin e punësimit ose daljen në pension, në bazë të gjinisë, racës, fesë, moshës, aftësive të kufizuara, orientimit seksual, kombësisë, anëtarësisë në sindikata, bindjes politike, grupimit social ose origjinës etnike.

Orari i punës: Furnitorët nuk do të kërkojnë nga punonjësit që të punojnë më shumë se orari i rregullt i punës dhe se orët shtesë të lejuara nga ligji në fuqi. Në asnjë rast orari i rregullt javor i punës nuk do të tejkalojë 48 orë, dhe punonjësit do të lejohen të bëjnë të paktën 24 orë të njëpasnjëshme pushim brenda çdo periudhe shtatëditore. E gjithë puna jashtë orarit do të jetë me konsensus. Furnitorët nuk do të kërkojnë orë shtesë rregullisht dhe do t'i kompensojnë orët shtesë të punës me pagesë më të lartë. Përveç rrethanave të jashtëzakonshme, shuma e orëve të rregullta dhe atyre shtesë të punës brenda një jave nuk do të tejkalojë 60 orë.

Kompensimi: Çdo punonjës ka të drejtën për kompensim për një javë pune të rregullt që mjafton për të plotësuar kërkesat bazë të punonjësit dhe pas plotësimit të tyre t'i mbeten të ardhura shtesë. Furnitorët do të paguajnë të paktën pagën minimale ose pagën përkatëse mbizotëruese, cilado është më e lartë, të respektojnë të gjitha kërkesat ligjore mbi pagat dhe të ofrojnë përfitimet shtesë që kërkohen nga ligji ose kontrata. Aty ku kompensimi nuk plotëson nevojat bazë të punonjësve dhe nuk lë të ardhura shtesë, Furnitorët do të marrin masat e duhura që kërkojnë të realizojnë në mënyrë progresive një nivel kompensimi që i plotëson këto.

Liria e shoqërimit dhe e negociatave kolektive: Furnitorët duhet të njohin dhe të respektojnë të drejtat e punonjësve për lirinë e shoqërimit dhe negociatat kolektive.

TË NDËRGJEGJSHËM PËR PLANETIN

Furnitorët do të miratojnë masa të përgjegjshme për të lehtësuar ndikimin negativ që kanë operacionet e tyre në mjedis. Minimalisht, kjo kërkon që Furnitorët të zbatojnë të gjitha ligjet lokale dhe ndërkombëtare në fuqi që mbrojnë mjedisin,

duke përfshirë magazinimin dhe eliminimin e përshtatshëm të substancave të rrezikshme dhe të përpigjen të zhvillojnë biznes në një mënyrë që minimizon konsumin e energjisë dhe mbetjet, optimizon përdorimin e burimeve natyrore dhe maksimizon riciklimin.

AUTENTICITETI I PRODUKTIT

Pajtueshmëria me ligjet: Përveç plotësimit të kërkesave të këtij Kodi Etike, Furnitorët do të zbatojnë të gjitha ligjet, rregulloret dhe traktatet në fuqi për operacionet e tyre.

Etika e Biznesit: Korrupsioni, zhvatja, përvetësimi i padrejtë dhe shtrembërimi i burimeve të produkteve ose materialeve nga Furnitorët, në çdo formë, është rreptësisht e ndaluar. Ky ndalim përfshin, por nuk kufizohet me, ofrimin ose pranimin e ryshfetit në këmbim të avantazheve të papërshtatshme dhe moszbulimin e burimeve të lëndës së parë kur kërkohet. Shkeljet e këtij ndalimi mund të rezultojnë në ndërprerje të menjëhershme të marrëdhënieve të Furnitorit nga ana e FOTL dhe përballjen e Furnitorit me masa ligjore.

Nënkontraktorët: Furnitorët nuk do të përdorin nënkontraktorë në prodhimin e produkteve dhe komponentëve të FOTL pa miratimin paraprak me shkrim të FOTL dhe vetëm pasi nënkontraktori të ketë rënë dakord me shkrim që të zbatojë këtë Kod Etike.

Pajtueshmëria doganore: Furnitorët do të jenë në pajtim me të gjitha ligjet doganore në fuqi dhe do të aplikojnë programe për t'u mbrojtur kundër praktikës së paligjshme të transportimit të produkteve në destinacione të ndërmjetme.

Siguria: Furnitorët do të aplikojnë procedura sigurie për t'u mbrojtur nga futja e mallrave jashtë listës së mallrave të transportuara (p.sh., droga dhe mallra të tjera kontrabandë) në dërgesat e produkteve të FOTL, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, pajtueshmërinë me kërkesat e Partneritetit Doganë-Tregti Kundër Terrorizmit (Customs-Trade Partnership Against Terrorism, C-TPAT) për dërgesat drejt Shteteve të Bashkuara.

IMPLEMENTIMI DHE ZBATIMI


Kërkesat e afishimit: Furnitorët duhet ta afishojnë këtë Kod Etike në një vend të dukshëm të aksesueshëm nga të gjithë punonjësit dhe vizitorët në gjuhët që kuptohen nga çdo punonjës, duke përfshirë edhe punonjësit e huaj emigrantë. Furnitorët do të komunikojnë dhe trajtojnë të gjithë punonjësit çdo vit në lidhje me elementet e këtij Kodi Etike.

Mbajtja e regjistrave: Furnitorët do të mbajnë regjistra të plotë dhe të saktë në lidhje me secilin nga elementet e këtij Kodi Etike për të lejuar verifikimin e pajtueshmërisë.

Direktivat e Furnitorëve; Manuali i Pajtueshmërisë Sociale të Entit të Licencuar: Aty ku është e zbatueshme, Furnitorët do të respektojnë kërkesat e detajuara në Direktivat e Furnitorëve dhe/ose Manualin e Pajtueshmërisë Sociale të Entit të Licencuar, që mund të gjenden në uebsajtin e korporatës të FOTL www.fotlinc.com.

Vlerësimet dhe masat korigjuese: FOTL përdor auditorë të jashtëm, si edhe të pavarur, për të kryer vlerësime në terren dhe/ose virtuale për t'u siguruar për pajtueshmërinë me këtë Kod Etike. Furnitorët do të bashkëpunojnë plotësisht me këto vlerësime dhe do të paraqesin për shqyrtim regjistrat e detajuar të pajtueshmërisë. Furnitorët do të bashkëpunojnë me FOTL për të zhvilluar plane masash korigjuese për t'iu drejtuar fushave ku nuk ka pajtueshmëri në një mënyrë të arsyeshme.

Raportimi i shkeljeve: Për të raportuar shkeljet e dyshuara të këtij Kodi Etike, kontaktoni me Departamentin e Përgjegjësisë Sociale të Korporatës së FOTL me telefon në numrin +1-270-935-2588, me email në code@fotlinc.com ose duke skanuar kodin në të djathtë duke përdorur një pajisje celulare. Ju lutemi të jepni informacione të detajuara në lidhje me palët e përfshira dhe në lidhje me shkeljet e dyshuara, hapat e ndërmarrë për ta zgjidhur çështjen drejtpërdrejt, dhe informacionet e kontaktit në mënyrë që të kontaktojmë në mënyrë konfidenciale lidhur me shqetësimin. Ne ndalojmë rreptësisht çdo hakmarrje ndaj personave që raportojnë shkelje të këtij Kodi Etike ose që asistojnë ose marrin pjesë në çfarëdo mënyre në ndonjë hetim të shkeljeve të mundshme të këtij Kodi Etike. Çdo hakmarrje duhet të raportohet te FOTL siç përcaktohet më lart.



Rish. Shkurt 2022



VANITY FAIR.

JERZEES.